

PROF. ASOC. DR. GJON BORIÇI

Instituti i Historisë / Akademia e Shkencave e Shqipërisë

Gjon.Borici@akad.gov.al

<https://doi.org/10.61773/6xnzv698>

**HESAP I QËRUAR APO LLOGARI E DËSHTUAR?
ANALIZA E MARRËDHËNIEVE POLITIKO-EKONOMIKE
PAS ACARIMIT STALIN-TITO NDËRMJET SHQIPËRISË
DHE JUGOSLLAVISË NË PERIUdhËN
QERSHOR 1948 – NËNTOR 1949**

Abstrakt:

Studimi analizon kthesën e madhe në marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave. Si shpjegohet që, në Plenumin VIII u ritheksua me forcë rruga e pandashme e bashkimit dhe e vëllazërimit me popujt e Jugosllavisë, dhe u dënuan si tradhtarë të gjithë ata që e kishin kundërshtuar këtë rrugë, ndërkohë që, në një periudhë shumë të shkurtër qëndrimi politik ndryshoi rrënjësisht? Klasa politike komuniste e asaj kohe duhej ta kishte kuptuar se pavarësia politike e një vendi është totalisht e pandarë me pavarësinë ekonomike të tij. Shqipëria nuk kishte as mundësinë më të vogël të ecte me këmbët e saj pa ndihmën ekonomike të një fuqie tjetër. Jugosllavia, për interesat e saj kombëtarë, ia kishte dalë mbanë ta mbante pas vetes Shqipërinë, por jo Bashkimin Sovjetik. Acarimi i marrëdhënieve ndërmjet këtyre dy vendeve pa dyshim që do të kishte ndikim të fortë tek udhëheqja komuniste shqiptare. Ky artikull studimor përqendrohet te pasojat ekonomike që pati për Shqipërinë dështimi i marrëdhënieve të ngushta e "vëllazërore" me Jugosllavinë. Do të përpiqem të shpjegoj, duke u mbështetur në dokumente autentike arkivore të prezantuara për herë të parë, pse prishja e marrëdhënieve të Shqipërisë me Jugosllavinë pati kryesisht pasoja ekonomike për vendin dhe aspak politike. Lidërshipi politik shqiptar doli pjesërisht i pacënuar nga kjo përplasje dhe, madje, forcoi edhe më shumë pozitën e tij. Në pjesën e fundit të artikullit, bëhet një analizë e hollësishme e pasojave ekonomike që pati Shqipëria në marrëdhëniet me Jugosllavinë, bazuar në dy materiale tepër sekrete për kohën, ku më i fundit është i vitit 1984. Metodologjia e përdorur në këtë artikull është analitiko-

ekonomike, e bazuar në njërën prej situatave më komplekse që kaloi lidhshipi politik shqiptar në fillim të Luftës së Ftohtë.

Fjalë kyçe:

Shqipëri, Jugosllavi, ekonomi, detyrime financiare, politikë.

Në vend të hyrjes

Siç e kam theksuar edhe në artikujt e mëparshëm, të botuar në tre numrat e fundit të revistës prestigjioze "Studime historike" të Institutit të Historisë në Akademinë e Shkencave të Shqipërisë, Shqipëria komuniste nuk e kishte të lehtë të mbyllte llogaritë me Jugosllavinë. Përveç anës politike, ajo që kishte dominuar më së shumti ishin marrëdhëniet ekonomike. Në mbështetje të politikës së saj, Jugosllavia e kishte detyruar Shqipërinë të themelonte shoqëri të ndryshme tregtare të përbashkëta, të cilat në fund do të çonin ujë vetëm në mullirin e Jugosllavisë. Më 25 shkurt 1947 u formuan tri shoqëri shqiptaro-jugosllave, të cilat filluan punën në mënyrë të rregullt më 1 prill të të njëjtit vit, sipas aprovimit të planit për vitin 1947.¹

Periudha nga viti 1947 deri në fillim të vitit 1948, siç e kam paraqitur në të tre artikujt e mëparshëm, përfaqëson fazën e nënshtrimit të plotë politiko-ekonomik të Shqipërisë ndaj Jugosllavisë. Megjithatë, ngjarjet për fatin e qeverisë komuniste shqiptare nuk do të rridhnin sipas planeve jugosllave. Edhe pse Beogradi nuk ishte përpjekur shumë për ta mbajtur Shqipërinë të dobët financiarisht, si pasojë e politikave tepër të gabuara ekonomike të kësaj të fundit, në këtë artikull do të paraqes, bazuar në dokumente autentike arkivore – shumë prej të cilave paraqiten për herë të parë – arsyet pse Shqipëria shpëtoi nga tutela jugosllave dhe sa i kushtoi politikisht dhe ekonomikisht kjo "liri" nga Jugosllavia e Titos.

¹ Arkivi Qendror Shtetëror i Republikës së Shqipërisë (më tej: AQSH), Fondi (më tej: F.) 14/Str, Viti (më tej: V.) 1946, Dosja (më tej: D.) 158, fleta (më tej: fl.) 60. Mbi ekonominë e Shqipërisë para dhe pas Çlirimit, mbi organizimin e industrisë, tregtisë, komunikacionit, financave etj.

Situata politiko-ekonomike në marrëdhënien Stalin-Tito përpara acarimit shqiptaro-jugosllav

Politika lindore dhe ballkanike e Stalinit gjatë viteve 1947-1948 ishte lehtësisht e lexueshme. Ai nuk kishte ndër mend të provokonte Perëndimin duke shkuar përtej asaj se çfarë ishte rënë dakord në Jaltë.² Kjo nënkuptonte se të gjitha shtetet e rajoneve të Europës Lindore dhe Qendrore duhej t'i përshtateshin regjimit sovjetik. Megjithatë, vetëm ky fakt nuk mjaftonte. Stalini kërkonte më shumë sesa nënshtrim, ai kërkonte besnikëri. Një nga udhëheqësit e Jugosllavisë, Milovan Gjilas, jo pak herë i kishte shprehur liderit suprem sovjetik besnikërinë e vendit të tij. Por, siç do të deklaronte më vonë vetë Gjilas, kjo besnikëri nuk u shpërblye; përkundrazi, vetëm sa u rrit arroganca e një vendi të madh ndaj një vendi të vogël ballkanik si në kohën cariste.³

Në konceptin e një tjetër lideri jugosllav, Eduard Kardelit, rruga që po ndiqte Jugosllavia për ndërtimin e socializmit ndryshonte nga ajo sovjetike. Ai shtronte pyetjen: A duhet socializmi të ndërtohet përmes bashkëpunimit midis popujve si të barabartë apo nëpërmjet rrugës së ekspansionizmit sovjetik?⁴ Dukej sikur Stalini fillimisht e kishte mbështetur projektin e Federatës Ballkanike ndërmjet Jugosllavisë dhe Bullgarisë, por kishte refuzuar që Shqipëria të përfshihej në të për momentin. Në një takim me Eduard Kardelin, kur ky i fundit e kishte informuar se ishte në udhë e sipër krijimi i një konfederate jugosllavo-shqiptare, Stalini e kishte ndërprerë, duke i thënë:

"..më parë një federatë ndërmjet Bullgarisë dhe Jugosllavisë, më pas të dyja me Shqipërinë".⁵

Thyerja e marrëdhënieve mes Stalinit dhe Titos kishte në thelb ekonominë, pavarësisht se asaj iu veshën ngjyra ideologjike për të fshehur arsyen e vërtetë. Gjatë gjithë vitit 1948, në Bashkimin Sovjetik

² Misha Glenny, *The Balkans 1804-1999; Nationalism, War and the Great Powers* (London: Granta books, 1999, 2000), 534.

³ *Po aty*.

⁴ Hilde Katrine Haug, *Creating a socialist Yugoslavia; Tito, communist leadership and the national question*, (London & New York: I.B. Tauris, 2012), 125.

⁵ *Po aty*, 127.

mbizotëroi një debat i madh për sa i përkiste idesë së "krizës së përgjithshme të kapitalizmit" – një debat që shpejt braktisi ngjyrat akademike dhe u bë tërësisht politik sipas vullnetit të Stalinit, i cili gjithnjë e më shumë e kishte lëshuar veten drejt forcave jovetore të historisë, të cilat, në fakt, ishin jashtë kontrollit të tij.⁶

Menjëherë pas përjashtimit të Jugosllavisë nga Komintern-i, SHBA-ja hoqi bllokadën e një sasive ari me vlerë 30 milionë dollarë që i përkiste shtetit jugosllav, e cila ishte depozituar atje nga ish-qeveria monarkike e atij vendi.⁷ Ndërsa një vit më vonë, në shtator 1949, SHBA-ja i akordoi kredinë e parë Jugosllavisë së Titos në shumën 20 milionë dollarë, e cila, edhe pse nuk u konsiderua e madhe, u quajt një transaksion normal biznesi.⁸ Duke u ndier i pafuqishëm për të detyruar Jugosllavinë t'i nënshtrohej ekonomikisht dhe, rrjedhimisht, politikisht BS-së, Stalini vendosi të luante kartën e destabilitetit të vendit. Ai u përpoq të dobësonte pozitat e Titos në vend duke parë edhe refuzimin e tij të mëtejshëm pas përjashtimit nga Kominform-i për të ndihmuar partizanët grekë në luftën civile, duke i nxitur këta të fundit të mbështetnin idenë e krijimit të një shteti të pavarur komunist të Maqedonisë, i cili më vonë do t'i bashkëngjitej Maqedonisë greke.⁹

Dominimi i Jugosllavisë mbi Shqipërinë, apo siç e konsideronte Stalini, "gëlltitja" e atij vendi, ishte vetëm rezultat i vendimit të Beogradit.¹⁰ Grindjes me Stalinin, Titoja iu përgjigj në mënyrë elokuyente më 13 prill 1948, duke deklaruar se:

"S'ka rëndësi sesa e do secili prej nesh tokën e Socializmit, BRSS, por në asnjë mënyrë nuk duhet ta dojë më pak vendin e tij i cili është duke zhvilluar socializmin".¹¹

Ndërsa në letrën që iu dërgua në të njëjtën datë Stalinit, Titoja theksonte më me forcë se:

⁶ Vojtech Mastny, *Il ditatore insicuro: Stalin e la Guerra Fredda*, përktheu nga anglishtja Annalisa Agrati, titulli i originalit, *The Cold War and the Soviet insecurity* (Milano: TEA, 1998), 76.

⁷ Richard J. Crampton, *The Balkans since the Second World War* (Essex: Longman, 2002), 118.

⁸ *Po aty*.

⁹ Dennis P. Hupchick, *The Balkans; From Constantinople to Communism* (New York: Palgrave, 2001), 391.

¹⁰ Barbara Jelavich, *History of the Balkans; Twentieth Century* (Cambridge & New York: Cambridge University Press, 1983), 324.

¹¹ *Po aty*, 326.

"Ne e studjojmë dhe e marrim si shembull sistemin sovjetik, por ne po zhvillojmë socializmin në vendin tonë në një formë disi ndryshe. Në këtë kohë, në rrethana specifike të cilat ekzistojnë në vendin tonë, duke marrë parasysh kushtet ndërkombëtare të cilat janë krijuar pas luftës çlirimtare, ne po përpiqemi të aplikojmë format më të mira të punës për realizimin e socializmit. Ne nuk e bëjmë këtë për t'ju provuar juve se rruga jonë është më e mirë se rruga e Bashkimit Sovjetik, apo se ne po shpikim diçka të re, por sepse kjo rrugë na është imponuar nga jeta jonë e përditshme".¹²

Jugosllavia u përjashtua nga Kominform-i në një datë historike, më 28 qershor 1948 (ditën e Vidovdanit, e cila përkujtonte Betejën e Fushë-Kosovës më 1389), duke e etiketuar Jugosllavinë si një regjim terrorist turk, i cili nuk mund të tolerohej nga një parti komuniste.¹³

Bashkimi Sovjetik pas Luftës së Dytë Botërore, deri në vdekjen e Stalinit më 1953, harxhoi për të kontrolluar ekonominë e Europës Qendrore dhe Lindore në formë kredish shumë prej 14 miliardë dollarësh – një shumë e cila ishte e barabartë me atë që harxhoi SHBA-ja me Planin Marshall për të ndihmuar në ringritjen ekonomike të Europës Perëndimore.¹⁴ Nga e gjithë kjo shumë peshën më të madhe të pagesave e mbajti RDGJ-ja, ndërsa Rumania i pagoi BS-së 1.7 miliardë dollarë, ndërkohë Jugosllavia u ankua se po shfrytëzohej ekonomikisht si më përpara.¹⁵ Keqinvestimi i të gjitha kredive nga ana e shteteve të kësaj pjese të kontinentit europian nuk solli zhvillimet e pritura ekonomike që edhe kjo pjesë e Europës të ecte me ritmin e Perëndimit. Sidomos shtetet e Ballkanit kreditë më të mëdha i investuan në industrinë e rëndë, veçanërisht në metalurgji dhe ndërtimin e makinerive.¹⁶

Kthesa e prerë politike e lidërsipit komunist të Shqipërisë në marrëdhëniet me Jugosllavinë

Duke parë rëndësinë e situatës, KQ i PKSH-së nuk hezitoi të bënte një kthesë të fortë në marrëdhëniet e Shqipërisë me Jugosllavinë.* Në

¹² *Po aty.*

¹³ *Po aty.*

¹⁴ *Po aty*, 344.

¹⁵ *Po aty.*

¹⁶ *Po aty*, 346.

* Shih gjerësisht pjesën e tretë të këtij studimi në "Studime historike", 2/2024.

komunikatën e KQ-së të datës 30 qershor 1948, e cila u botua në gazetën “Bashkimi” më 1 korrik 1948, u theksua se, pasi u mor në shqyrtim rezolucioni i Informbyrosë, PKSH-ja dhe Komiteti Qendror i saj, ishin plotësisht dakord me vijën e ndjekur nga Informbyroja ndaj PKJ-së.¹⁷ Jo vetëm kaq, por komunikata guxoi edhe më tej duke pohuar se KQ i PKSH-së kishte qenë gjithnjë në konflikt me KQ të PKJ-së,¹⁸ çka ishte një e pavërtetë e madhe. Përveç kësaj, KQ i PKJ-së u akuzua se kishte shtrembëruar marrëdhëniet ekonomike dhe politike me Shqipërinë dhe se kishte goditur disa herë KQ të PKSH-së.¹⁹

Në këtë komunikatë, Jugosllavia u akuzua se ishte përpjekur të zhdukte pavarësinë e Shqipërisë dhe t'i impononte popullit shqiptar një politikë shtypjeje sipas modelit kapitalist.²⁰ Sipas komunikatës, Shqipëria ia kishte dalë të mbijetonte nga kjo politikë e egër ekonomike e Jugosllavisë ndaj saj vetëm në saje të ndihmës që i kishte dhënë Bashkimi Sovjetik,²¹ kur dihet fare mirë, siç e kam paraqitur në pjesët e mëparshme të këtij studimi, se kishte qenë pikërisht ky i fundit që i kishte lënë dorë të lirë Jugosllavisë mbi Shqipërinë. Të gjitha këto deklarata të bujshme, të paraqitura në komunikatën e KQ-së, ishin marrë në mbledhjen e jashtëzakonshme të Plenumit të Komitetit Qendror, mbajtur më 27 qershor 1948.²²

Sulmet politike që KQ i Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik (PKBS) i kishte drejtuar KQ të PKJ-së përbënin thelbin e qëndrimit të Shqipërisë ndaj Jugosllavisë. Në fakt, janë të shumta letrat që i janë dërguar PKJ-së nga PKBS-ja, të cilat nuk përmbajnë thelbin e acarimit të vërtetë në marrëdhëniet ndërmjet të dyja vendeve. Disa prej këtyre letrave

¹⁷ AQSH, F. 14/Organet Udhëheqëse (më tej: OU), V. 1948, D. 48, fl. 1-3. Rezolutë e KQ të PKSH-së për dënimin e rrugës antisovjetike dhe antimarksiste të PKJ-së.

¹⁸ *Po aty*. Pjesë nga komunikata: "Komiteti Central i Partisë Komuniste Shqiptare ka qenë vazhdimisht në konflikt me Komitetin Central të Partisë Komuniste Jugosllave, i cili është përpjekur t'i imponojë vendit tonë dhe Partisë sonë metodat dhe politikën e tij tradhtarë, armiqësore, trockiste. Komiteti Central i Partisë Komuniste Jugosllave, me në krye Titon, kanë shtrembëruar të gjitha marrëdhëniet ekonomike dhe politike me vendin tonë, marrëdhënie që lindën në shenjë të një vëllazërimi të madh të farkëtuar nga popujt e Shqipërisë dhe Jugosllavisë në luftën më të përgjakshme që ka parë bota".

¹⁹ *Po aty*.

²⁰ *Po aty*, fl. 2.

²¹ *Po aty*.

²² *Po aty*, fl. 4.

gjenden në dokumentacionin arkivor shqiptar. Nga hulumtimi i kujdesshëm i tyre, rezulton se thuajse të gjitha ishin në të njëjtën linjë, ku dënohej rruga e gabuar antimarksiste e PKJ-së dhe e Titos në veçanti.²³ Në këto letra, udhëheqësit e PKJ-së u cilësuan si tradhtarë të marksizëm-leninizmit dhe u konsideruan demagogë.²⁴ Madje, "tradhtarët" jugosllavë, përmes politikës së ndjekur prej tyre, kishin mbjellë urrejtje ndaj BS-së dhe kishin mohuar rolin çlirimtar të Ushtrisë së Kuqe.²⁵ Synimi i letrave të dërguara nga KQ i PKBS-së ishte që PKJ-ja të braktiste rrugën e tradhtisë ndaj marksizëm-leninizmit për interesin e saj dhe të të gjithë Kampit Socialist.²⁶ Sipas letrave, Titoja kishte refuzuar të njihte "gabimet" dhe madje i kishte quajtur akuzat e bëra nga BS-ja si shpifje, duke i shpallur luftë politike Partisë Bolshevike, e cila u konsiderua e denjë vetëm për vende shërbëtore të imperializmit.²⁷

Titoja u akuzua gjithashtu se po mbante nën terror partinë dhe po afronte gjithnjë e më shumë pranë saj elementët më shovinistë.²⁸ Tashmë PKSH-së nuk i mbetej gjë tjetër, veçse të bënte justifikime të forta për të bindur vetëm BS-në dhe aspak anëtarët e partisë apo popullin shqiptar, të cilët ishin thjesht turmë, se sa "armik" i rrezikshëm paskësh qenë Jugosllavia dhe se vetëm BS-ja e kishte shpëtuar Shqipërinë.²⁹ Që prej këtij momenti, marrëdhëniet më të ngushta PKSH-ja dhe Shqipëria do t'i kishin vetëm me BS-në, i cili u konsiderua sërish si atdheu i lavdishëm i socializmit.³⁰

Në justifikimet e KQ të PKSH-së dhe personalisht të Enver Hoxhës, vetëvrasja e Nako Spirut u konsiderua si dhurata më e madhe që ai u bëri jugosllavëve dhe dënimi i tij nga PKSH-ja ishte rënie në grackën

²³ *AQSH*, F. 14/OU, V. 1948, D. 48/a, fl. 1-4. Letra të Partisë Bolshevike drejtuar Komitetit Qendror të Partisë Komuniste Jugosllave.

²⁴ *Po aty*, fl. 1.

²⁵ *Po aty*, fl. 2.

²⁶ *Po aty*, fl. 3. "Qëllimi i letrave të Partisë së Lavdishme Bolshevike, drejtuar Komitetit Central të Jugosllavisë, ka qenë që udhëheqësit e Partisë Jugosllave, të shkëputeshin dhe të dënonin njëherë e përgjithmonë këtë rrugë që i çonte në tradhti, të njihnin ndershmërisht gabimet e tyre kaq të rrezikshme, t'i korrigjonin këto gabime për interesin e madh të Partisë së Tyre, të popujve të tyre dhe në interesin e Kampit të Socializmit".

²⁷ *Po aty*.

²⁸ *Po aty*, fl. 4.

²⁹ *Po aty*, fl. 45-52.

³⁰ *Po aty*, fl. 63.

e titistëve.³¹ Në *meaculpa*-n e KQ të PKS-së u vërtetua se Nako Spiru nuk kishte qenë as spiun dhe as tradhtar. Përkundrazi, etiketime të tilla që i ishin bërë pas vdekjes kishin qenë shpifje të jugosllavëve dhe i vetmi defekt që ai kishte pasur ishte ambicja e tij e ekzagjeruar.³² Sipas KQ-së, më të thjeshtë rehabilitimin e kishte Mehmet Shehu, pasi ishte "vërtetuar" se ai nuk dëshironte shtrembërimin e vijës së partisë.³³ Po ashtu, edhe masat që ishin marrë në Plenumin VIII ndaj Liri Belishovës dhe Fadil Paçramit duhej të "korrigoreshin".³⁴ Edhe pse po bëheshin "korrigjime" të gabimeve, sipas Enver Hoxhës, përsëri, nën shembullin e letrave që BS-ja i kishte dërguar Jugosllavisë, lufta e klasave nuk do të zbutej, por do të ashpërsohej edhe më shumë.³⁵

Në këtë mbledhje u vendos që Kongresi I i PKS-së të mblidhej jo më vonë se dy muaj, me qëllim legalizimin e partisë. Kjo detyrë u ngarkua Komitetit Qendror, i cili gjithashtu duhej të hartonte edhe rendin e ditës së Kongresit, si dhe të përzgjidhte personat që do të referonin në të.³⁶ Po ashtu, një tjetër detyrë që u shtrua në këtë mbledhje, ishte edhe ajo ngritjes së nivelit ideologjik të masave, duke qenë se ai ishte tepër i ulët, dhe për këtë arsye duheshin bërë përpjekje të mëdha për edukimin marksist-leninist të tyre.³⁷ Gjithashtu, analiza e bërë në muajin shkurt, gjatë Plenumit VIII, u konsiderua si gabimi më i madh që kishte bërë ndonjëherë KQ i PKS-së.³⁸ Në fund të mbledhjes, u vendos që rehabilitimi i të gjithë "shokëve" të goditur padrejtësisht në Plenumin VIII të bëhej i plotë dhe me zemër, sipas mësimave të Zhdanovit.³⁹

³¹ *Po aty*, fl. 54.

³² *Po aty*, fl. 94.

³³ *Po aty*, fl. 99.

³⁴ *Po aty*, fl. 100.

³⁵ *Po aty*, fl. 106.

³⁶ *Po aty*, fl. 124.

³⁷ *Po aty*. "Duke marrë parasysh nivelin e ulët ideologjik të masave të gjera të Partisë sonë, Komiteti Central duhet të marrë të gjitha masat për të forcuar edukimin Marksist-Leninist të Kuadrove të Partisë s'onë. Të krijojë shkollën e partisë dhe të krijojë një seri kursesh në qendra të tjera ku të shkojnë anëtarët e partisë dhe të armatosen me shkencën Marksiste-Leniniste".

³⁸ *Po aty*, fl. 179.

³⁹ *Po aty*, fl. 213. "Zhdanovi gjithashtu na mëson: "Duhet t'i jepet fund praktikës së rehabilitimit me gjysëm zemër. Në qoftë se një njeri meriton të rehabilitohet plotësisht, çdo dënim duhet të shlyhet prej kujtimit të tij". Këto parime të mëdha të Partisë Bolshevike të na udhëheqin në punën tonë, t'i kuptojmë mirë, t'i ndiejmë thellë".

Mbi këtë frymë u mbajt i famshmi Plenum XI, në të cilin Enver Hoxha bëri *meaculpa*-n e madhe të PKSH-së më 13 shtator 1949, të cilën e analizuam më lart.⁴⁰ Fjalimi i tij i stërzgatur prej 126 faqesh të daktilografuara ishte një shfaqësime plotë i politikave të tij tejet të gabuara në lidhje me udhëheqjen e Shqipërisë. Nuk do të ishte hera e parë që ai do të bënte manovra të tilla, pasi autoriteti që kishte edhe pas prishjes me Jugosllavinë mbetej i pasfidueshëm. Askush brenda radhëve të PKSH-së nuk guxoi të ngrihej e t'i thoshte në sy se i gjithë faji ishte i tij. Të gjithë pritën dënimin e grupit projugosllav të Koçi Xoxes,⁴¹ kur më projugosllav kishte qenë Hoxha vetë. Në pjesët e mëparshme të këtij studimi, të botuar në revistën "Studime historike", e kam treguar me fakte se ai ishte njeriu i jugosllavëve, gjë të cilën nuk e kishte fshehur aspak edhe vetë. Politikanët e atëhershëm shqiptarë po i linin vendit një trashëgimi tepër të hidhur, të cilën edhe sot e kësaj dite nuk po e shmangim: drejtësinë e padiskutueshme të autoritetit të "Njëshit". Kultet e individit të udhëheqësve politikë shqiptarë, pas përfundimit të Luftës së Parë Botërore e deri në ditët tona në shek. XXI, për fat të keq vijojnë të jenë pjesë e kulturës politike të Shqipërisë.

Nuk kam ndër mend që, përveç analizës së mbajtur nga Enver Hoxha, të analizoj diskutimet e pjesëmarrësve të tjerë, të cilat, po të them mediokre, u bëj nder. Të gjithë diskutantët, duke filluar nga Enver Hoxha, Naxhije Dume, Bedri Spahiu, Manush Myftiu, Tahir Kadare, Tuk Jakova, Kiço Ngjela, Pëllumb Dishnica etj., ishin dhe mbeten një mjerim i vërtetë i arsytimit politik.⁴²

Të gjithë këta "politikanë" njëri pas tjetrit ngritën dorën për të dënuar njeriun që ishte përgjegjës për situatën e padëshiruar që po kalonte partia – dhe ky njeri ishte Koçi Xoxe. Plenumi VIII u hodh poshtë si gabimi më i rrezikshëm që kishte bërë deri atëherë PKSH-ja dhe u konsiderua antimarksist, si dhe nënshtrim i plotë i Shqipërisë ndaj Jugosllavisë.⁴³ Ndër vendimet më të bujshme dhe që ishin të prishme

⁴⁰ *AQSH*, F. 14/OU, V. 1948, D. 49, fl. 1-127. Raport i Enver Hoxhës mbajtur në Plenumin XI të PKSH-së, më datë 13 shtator 1948.

⁴¹ Sabit Syla & Qerim Lita, *Marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave 1944-1948*, Dokumente, vëll. I (Prishtinë: Instituti i Historisë, 2020), 285.

⁴² *AQSH*, F. 14/OU, V. 1948, D. 49/3, fl. 289-316. Diskutime të pjesëmarrësve në Plenumin XI, të mbajtur nga data 13-24 shtator dhe 30 shtator 1948.

⁴³ *Po aty*, F. 14/OU, V. 1948, D. 49/1, fl. 12. Vendime të Plenumit XI të KQ të PKSH-së, 30 shtator 1948.

ishte rehabilitimi i Nako Spirut, i cili u konsiderua viktimë e intrigave të Jugosllavisë.⁴⁴ Po ashtu, u vendos që të hiqej nga qarkullimi rezolucioni i Plenumit VIII të KQ, si i gabuar, antimarksist dhe antisovjetik. Mbi të gjitha, u vendos që Koçi Xoxe të shkarkohej menjëherë nga detyra e sekretarit organizativ, por të lejohej të mbetej anëtar i Byrosë Politike të PKSH-së deri në mbajtjen e Kongresit I.⁴⁵ Kjo masë ndaj Xoxes u mor sipas vendimeve, pasi ai kishte qenë shumë i ndikuar nga politika jugosllave dhe nuk i kishte "kuptuar" mirë gabimet e tij, si dhe autokritika që kishte bërë përpara KQ-së nuk kishte qenë e "shëndoshë".⁴⁶ Pa dyshim që është shumë e vështirë të besohet se Enver Hoxha po e falte Xoxen. Ndoshta kryeministri dhe kryetari i partisë ishte në pritje se mos vallë Titoja dhe Stalini i rregullonin sërish marrëdhëniet dhe Shqipëria i mbetej përsëri tutelës jugosllave. Çfarë ka menduar Hoxha në këtë 30 shtator 1948, nuk mund ta dimë, por ajo që dimë me siguri është se ai vendosi të priste edhe pak për të goditur përfundimisht Koçi Xoxen dhe njerëzit e konsideruar "të tij".

Një tjetër problem që mund t'i dilte Enver Hoxhës ishte edhe situata e brendshme e vendit. Ai duhej të ishte i sigurt se nuk do të kishte probleme kur të njoftohej publikisht populli shqiptar mbi denoncimin e marrëveshjeve dhe traktateve me Jugosllavinë. Sigurimi i Shtetit më 29 shtator 1948, pas përfundimit të Plenumit XI, dërgoi një informacion të hollësishëm lidhur me situatën në vend pas denoncimit të Jugosllavisë.⁴⁷ Sipas informacionit, vërehej një rritje e aktivitetit të elementit kundërshtar, megjithatë pa dhënë specifikime konkrete; situata përshkruhej thjesht si "influencim i drejtpërdrejtë nga gjendja e krijuar në PKJ".⁴⁸ Relacioni i Sigurimit njoftonte gjithashtu se, nga parullat e hedhura dhe nga bisedat e përgjuara [pa specifikime], veprimi i

⁴⁴ *Po aty*, fl. 39. Pjesë nga vendimet e marra në Plenumin XI: "Shoku Nako Spiru të konsiderohet si viktimë e intrigave të poshtra të udhëheqësve trockistë nacionalistë jugosllavë dhe që ka mbrojtur vijën e Partisë kundër qëllimeve të poshtra të grupit trockist Tito, dhe që e ka dashur Bashkimin Sovjetik". Për rehabilitimin e Nako Spirut shih edhe gazetën *Zëri i Popullit*, Tiranë, 30 nëntor 1977, 3.

⁴⁵ *AQSH*, F. 14/OU, V. 1948, D. 49/1, fl. 39-40.

⁴⁶ *Po aty*, fl. 40.

⁴⁷ *Arkivi i Ministrisë së Punëve të Brendshme /Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit* (më tej: *AMPB/AIDSSH*), Drejtoria e Sigurimit të Shtetit, Viti (më tej: V.) 1948, Dosja (më tej: D.) 24, fleta (më tej: fl.) 1-3. Relacion rreth situatës aktuale në vend pas tradhtisë së revizionistëve jugosllavë.

⁴⁸ *Po aty*, fl. 1.

Shqipërisë konsiderohej aventurier dhe se, në rast se vendi do të sulmohej nga Italia, Jugosllavia dhe Greqia, ai do të pushtohej brenda për tri orëve.⁴⁹ Po ashtu, situata e vështirë ekonomike që po kalonte vendi pas prishjes me Jugosllavinë kishte gjetur, sipas Sigurimit, terren në hedhjen e parullave disfatiste se "tani do të vdesim fare sepse jemi të bllokuar e nuk ka kush të na ndihmojë".⁵⁰ Parullat e shkruara nëpër mure ishin gjetur në Shkodër, Koplik, Lezhë, Shijak, Tiranë etj.⁵¹ Këto lëvizje i kishin dhënë mundësi forcave të Sigurimit që të intensifikonin goditjet dhe arrestimet në qytetet e lartpërmendura, veçanërisht në Shkodër.⁵²

Agjentët e Sigurimit raportonin edhe provokacionet, sipas tyre, në kufirin shqiptaro-jugosllav prej fqinjëve veriorë. Sipas dokumenteve të hulumtuara për periudhën korrik-dhjetor 1948, është konstatuar se ka pasur vazhdimisht shkelle të kufirit nga ana e jugosllavëve, si dhe hedhje fletushkash nga avionët me përmbajtje kundër pushtetit të atëhershëm në Shqipëri.⁵³ I gjithë viti 1948 është i mbushur plot e përplot me informacione nga ana e Sigurimit në lidhje me situatën në Shqipëri pas Plenumit VIII dhe, mbi të gjitha, pasi u "zbulua" tradhtia e jugosllavëve. Nga muaji shkurt 1948 e deri në fund të majit, agjentët e Sigurimit përgjonin gjithçka që flitej kundër Jugosllavisë dhe, jo pak herë, arrestonin njerëz si antijugosllavë.⁵⁴ Sigurimi sillte në Tiranë nga çdo rreth i vendit informacione të panumërta, kryesisht mbi pakënaqësitë që kishin njerëzit për situatën e vështirë ekonomike.⁵⁵ Jo vetëm kaq, por sipas njoftimeve të paraqitura nga Ministria e Punëve të Jashtme në Tiranë, për të cilat ishte njoftuar edhe ambasada jugosllave, ishin arrestuar edhe nënshtetas jugosllavë që kishin shkelur kufirin mes dy

⁴⁹ *Po aty*.

⁵⁰ *Po aty*.

⁵¹ *Po aty*, fl. 2.

⁵² *Po aty*.

⁵³ *Po aty*, Drejtorja e Sigurimit të Shtetit, V. 1948, D. 32, fl. 1-7. Njoftime nga Drejtorja e Sigurimit të Shtetit, mbi provokacionet e bëra nga jugosllavët në kufirin shqiptar gjatë periudhës korrik-dhjetor 1948. Informacioni është përgatitur më datë 24 janar 1949.

⁵⁴ *Po aty*, Drejtorja e Sigurimit të Shtetit, V. 1948, D. 35, fl. 1. Buletinë të Drejtorisë së Sigurimit të Shtetit, mbi komentet dhe parullat e elementit armik rreth situatës në Shqipëri pas Plenumit VIII dhe zbulimit të tradhtisë së Jugosllavisë.

⁵⁵ *Po aty*, fl. 3-5.

vendeve.⁵⁶ Herë pas here, ambasada shqiptare në Beograd dërgonte nota proteste në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Jugosllavisë lidhur me strehimin, sipas saj, të "kriminelëve" shqiptarë të luftës në vendin fqinj, duke kërkuar që ata të arrestoheshin dhe të dërgoheshin sa më parë në Shqipëri.⁵⁷

Dilemat ekonomike të Shqipërisë pas acarimit me Jugosllavinë

Me Jugosllavinë, tashmë Shqipëria e kishte të domosdoshme të ndërpriste të gjitha marrëdhëniet, veçanërisht ato ekonomike. Më 20 korrik 1948, në selinë e Bankës së Shtetit Shqiptar, u kryen dorëzimet e fundit për mbylljen e llogarive të Bankës Shqiptaro-Jugosllave.⁵⁸ Mbyllja e kësaj banke u shoqërua edhe me likuidimet e fundit të faturave që Shqipëria i detyrohej për objektet e prodhimit të pajisjeve dhe mallrave të ardhura nga Jugosllavia.⁵⁹ Nga ish-Banka Shqiptaro-Jugosllave iu dorëzuan BSHSH-së 478 fatura për një shumë komplekse prej 10 096 757 lekësh, si detyrim për t'u paguar nga pala shqiptare.⁶⁰ Jugosllavia ishte treguar shumë herë më e zgjuar në manovrat financiare sesa Shqipëria. Suksesi më i madh ekonomik i Jugosllavisë ndaj Shqipërisë ishte pariteti lek/dinar, kur dallimi mes frangës shqiptare dhe monedhës jugosllave ishte 1 frangë=12,58 dinarë, dhe në disa raste 1 frangë=13,14 dinarë.⁶¹ Vetëm tani u kuptua dëmi i madh që kishte sjellë dekretligji nr. 443 i

⁵⁶ *Arkivi i Ministrisë për Europën dhe Punët e Jashtme i Republikës së Shqipërisë* (më tej: *AMEPJ*), Viti (më tej: V.) 1948, Dosja (më tej: D.) 174, fleta (më tej: fl.) 1. Njoftime të MPJ-së në Tiranë, mbi incidentet kufitare mes dy vendeve (Shqipërisë dhe Jugosllavisë), 15 gusht 1948.

⁵⁷ *Po aty*, V. 1948, D. 219, fl. 5-6. Notë proteste e ambasadës shqiptare në Beograd, 10 shtator 1948. Po ashtu, më datë 3 dhjetor, ambasada shqiptare në Beograd njoftonte MPJ-në në Tiranë lidhur me mbrojtjen që i jepnin autoritetet jugosllave të arratisurit Ëngjëll Selenica, *po aty*, fl. 18-19.

⁵⁸ *AQSH*, F. 506/Banka e Shtetit Shqiptar (më tej: BSHSH), V. 1948, D. 4, fl. 1. Mbyllja e Bankës Shqiptaro-Jugosllave.

⁵⁹ *Po aty*. Pjesë nga procesverbali: "U muar në dorëzim dy situacione të palikujduar të Minierës së Selenicës për muajin shkurt 1948 me objekte "Prodhimi" dhe "Kërkime" Lek 282.307.50, "Drejtoria e re" dhe "bateritë e kazanëve" Lek 236.398".

⁶⁰ *Po aty*, fl. 3.

⁶¹ *AMEPJ*, V. 1948, D. 167/1, fl. 63. "Bilan general des relations avec Yougoslavie/Bilanc i përgjithshëm i marrëdhënieve me Jugosllavinë; shih edhe *po aty*, fl. 65, këmbimin e monedhave të tjera me lekun shqiptar, 1\$=50 lekë; 1 paund=201,50 lekë; 100 franga zvicerane=1162,79 lekë; 100 franga franceze=23,38 lekë; 100 dinarë [K.O.S]=100 lekë; 1 frangë ari=16,30 lekë".

datës 7 korrik 1947 për paritetin e monedhave respektive shqiptare dhe jugosllave, sipas të cilit 1 frangë ari shqiptare u këmbye me 9 lekë dhe rrjedhimisht me 9 dinarë jugosllavë, çka nuk i korrespondonte vlerës reale të të dyja monedhave (frangës dhe dinarit).⁶²

Përveç kostos financiare që kishte prishja e marrëdhënieve me Jugosllavinë, Shqipëria kishte edhe një problem tjetër. Saldoja financiare për vitin 1947, duke përfshirë marrëveshjet që nga viti 1945, sipas një informacioni të MPJ-së në Tiranë, ishte 3 138 464 737, 35 dinarë jugosllavë.⁶³ Edhe pse ekzistonte një marrëveshje e paritetit mes lekut dhe dinarit, Jugosllavia kërkonte që të gjitha pagesat e likuidimeve nga ana e Shqipërisë t'i bëheshin në dinarë jugosllavë.⁶⁴ Për këtë arsye, Drejtoria e BSHSH-së me udhëzimin e datës 16 korrik 1948 u kërkonte të gjitha degëve në rrethe që të fillonin të blinin dinarë, por jo më të mëdha se prerjet 50-she dhe jo më shumë se 500.⁶⁵ Borxhi i Shqipërisë ndaj Jugosllavisë ishte tepër i lartë, siç dëshmohet edhe në një promemorie të përgatitur nga MPJ-ja e Shqipërisë për vitin 1948, ku shprehet qartë shqetësimi lidhur me kredinë e dy miliardë dinarëve akorduar nga qeveria jugosllave.⁶⁶ Megjithatë, qeveria shqiptare ishte e vendosur për të shkëputur çdo marrëdhënie me Jugosllavinë dhe, më 1 shtator 1948, nëpërmjet një njoftimi dërguar nga MPJ-ja ambasadave shqiptare në Moskë, Sofje, Bukuresht dhe Paris, njoftohej denoncimi i çdo marrëveshjeje me Jugosllavinë.⁶⁷ Ky njoftim u bë pasi më datë 21 korrik 1948, Ministria e Punëve të Jashtme e RPSH-së i dërgoi ambasadës jugosllave notën zyrtare të denoncimit të të gjitha marrëdhënieve dhe akordeve të nënshkruara ndërmjet dy vendeve.⁶⁸ Ndërsa më datë 24 gusht 1948, ambasada shqiptare në Beograd me një tjetër notë, rikonfirmoi

⁶² *Po aty*, fl. 62.

⁶³ *Po aty*, fl. 171.

⁶⁴ *AQSH*, F. 506/BSHSH, V. 1948, D. 5, fl. 3. Blerje dinarësh nga Banka e Shtetit Shqiptar në qendër e rrethe.

⁶⁵ *Po aty*. Pjesë nga udhëzimi i Bankës: "Në mbarimin e afatit prej dy deri tre ditësh, blerja e dinarëve do të kryhet pikërisht si për të gjitha valutat e tjera, d.m.th. nuk do të bleni më tepër se dinarë 500... në premje jo më të mëdha se dinarë 50".

⁶⁶ *AMEPJ*, V. 1948, D. 161, fl. 27. Promemorie (pa datë) e Ministrisë së Punëve të Jashtme, mbi kreditin e dy miliardë dinarëve, akorduar nga Jugosllavia.

⁶⁷ *Po aty*, fl. 51.

⁶⁸ *Po aty*, fl. 52-61.

qëndrimin e qeverisë shqiptare me notën përkatëse dërguar Ministrisë së Punëve të Jashtme të Jugosllavisë.⁶⁹

Shqipëria për të likuiduar mallrat që kishte marrë nga Jugosllavia dhe nga Bashkimi Sovjetik kishte nevojë urgjente për të pasur gjendje valutë të huaj. Duke qenë se leku shqiptar nuk ishte i konvertueshëm në këtë kohë, dollari amerikan shihej si monedha më e fortë dhe më e qëndrueshme për të kryer pagesat. Për këtë arsye, gjatë viteve 1947-1948 janë blerë 1 544 503,00 dollarë (1947) dhe 1 123 503,00 dollarë për vitin 1948.⁷⁰

Vijimi i situatës së acartë në marrëdhëniet Shqipëri-Jugosllavi për vitin 1949

Pas "zbulimit" të tradhtisë së madhe jugosllave në rrugën e marksizëm-leninizmit në vitin 1948, edhe për vitin 1949 marrëdhëniet ndërmjet Shqipërisë dhe Jugosllavisë ishin në pikën më të ulët të mundshme. Që më 25 janar 1949, u njoftua nga MPJ-ja e Shqipërisë se problematikat e radhës në marrëdhëniet me Jugosllavinë ishin: refuzimi i vizave të ndërsjella, lejimi i kalimit të varkave jugosllave nga liqeni i Shkodrës në Adriatik, lirimi i shtetasve jugosllavë të kapur për kalim të paligjshëm kufiri (shumica e të cilëve ishin barinj që kullotnin bagëtitë), kthimi i 100 mijë dinarëve një shtetasi jugosllav që i ishin sekuestruar në Shqipëri kur do të largohej prej saj, si dhe shkëmbimi i mallrave reciproke që ndodheshin në të dyja vendet.⁷¹ Për këtë arsye, u vendos që të shkonte në Beograd për bisedime një delegacion zyrtar shqiptar.

Përfaqësuesi jugosllav në Tiranë, Drago Kosmrlj, në një takim të mbajtur në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Shqipërisë me Halim Budon, më 18 shkurt 1949, shprehu hapur pakënaqësinë e palës jugosllave për qëndrimet armiqësore nga ana e Shqipërisë ndaj vendit të

⁶⁹ *Po aty*, fl. 121.

⁷⁰ *AQSH*, F. 506/BSHSH, V. 1948, D. 8, fl. 1. Blerje dollarësh nga BSHSH-ja për vitet 1947-1948, gjithsej 2 668 006,00 dollarë.

⁷¹ *AQSH*, F. 14/Str., V. 1949, D. 469, fl. 1. Relacione, informata dhe materiale të tjera lidhur me marrëdhëniet midis Shqipërisë dhe Jugosllavisë, mbi pretendimet e palës jugosllave për trajtimin e shtetasve jugosllavë, për shkëmbimin e postës, mbi ndalimin e vizave për ardhjen e shtetasve shqiptarë nga Jugosllavia, si dhe mbi punën e delegacionit shqiptar për reparacionet e mbetura në Jugosllavi dhe mbi denoncimin e Konventës ekonomike dhe të të gjitha marrëveshjeve dhe protokolleve që kishin lidhje me të.

tij, veçanërisht për shkak të arrestimeve të nënshtetasve jugosllavë, të cilat, sipas tij, ishin kryer krejtësisht në mënyrë të paligjshme.⁷² Për të gjitha këto veprime, ai protestoi energjikisht dhe kërkoi që të arrestuarit të liroheshin dhe të riatdhesoheshin, si dhe veprime të tilla të mos përsëriteshin më.⁷³

Halim Budo nga ana e tij bëri të paditurin, por theksoi se veprimet e palës shqiptare kishin qenë dhe do të ishin gjithnjë korrekte. Madje, ai akuzoi palën jugosllave se kishte treguar armiqësi të theksuar ndaj shtetasve shqiptarë në Jugosllavi, si dhe i përmendi diplomatit jugosllav shkëljen e paprecedent të pavarësisë së ambasadës shqiptare në Beograd nga agjentët e UDB-së.⁷⁴ Lidhur me këtë ngjarje, Kosmrlj e pranoi se ishte vepruar gabim, duke e justifikuar me faktin se organet e policisë nuk ishin instruktuar mirë dhe nuk i njihnin rregullat.⁷⁵ Incidenti në ambasadën shqiptare në Beograd kishte qenë vërtet i rëndë pasi dy agjentë të UDB-së më datë 31 janar 1949 ishin futur rreth orës 11:00 në ambasadë për të arrestuar shtetasin shqiptar Hajredin Hica.⁷⁶ Sekretari i dytë i ambasadës shqiptare e kishte ndaluar këtë veprim duke i kujtuar agjentit të UDB-së se po shkelte në territorin e një vendi sovran dhe se një arrestim i tillë nuk mund të kryhej në asnjë mënyrë.⁷⁷

Me gjithë situatën e acaruar mes dy vendeve, disa muaj më vonë – dhe saktësisht më 28 shtator 1949 – legata jugosllave në Tiranë njoftoi MPJ-në e Shqipërisë se, sipas urdhrave që kishte marrë, do të lejonte pajisjen me viza të shtetasve shqiptarë të cilët do të kalonin tranzit nëpërmjet territorit jugosllav drejt shteteve të tjera.⁷⁸ Pavarësisht lëshimeve të bëra, situata vijonte të mbetej e tensionuar, pasi Ministria e Punëve të Jashtme e Shqipërisë e akuzonte Jugosllavinë se mbante në arrest gjashtë kursantë shqiptarë që kishin shkuar në Jugosllavi për

⁷² *Po aty*, fl. 3.

⁷³ *Po aty*, fl. 3-4.

⁷⁴ *Po aty*, fl. 4.

⁷⁵ *Po aty*. Pjesë nga fjala e Kosmrlj: "Unë mendoj se të gjitha këto ngjarje nuk mund të fshihen me të ashtuquajturat ngjarje në Jugosllavi. Ajo që ka ndodhur në Legatën tuaj është një gabim, që e ka shpjeguar Ministria e Jashtme Jugosllave, e organit policor tonë i cili nuk i dinte mirë rregullat".

⁷⁶ *AMEPJ*, V. 1949, D. 163, fl. 1. Njoftim rreth incidentit të rëndë të ndodhur në ambasadën shqiptare në Beograd, 2 shkurt 1949.

⁷⁷ *Po aty*.

⁷⁸ *AMEPJ*, V. 1949, D. 162, fl. 106. Njoftim i legatës jugosllave për MPJ-në në Tiranë, 28 shtator 1949.

specializim.⁷⁹ Po ashtu, legata jugosllave në Tiranë dërgonte vazhdimisht nota proteste në MPJ për arrestimin e shtetasve shqiptarë nga organet kompetente në Shqipëri.⁸⁰ Jo pak herë, Shqipëria e akuzonte Jugosllavinë se strehonte kriminelë shqiptarë të luftës që kërkoheshin nga drejtësia shqiptare, ndër të cilët edhe njëfarë Zef Zogu, i biri "ilegjitim?" i ish-Mbretit Zog, me profesion bujk nga rrethi i Tropojës.⁸¹ Qeveria shqiptare me shkresën dërguar legatës jugosllave më 28 shkurt 1949, kërkonte kthimin e tyre në Shqipëri.⁸² Sipas dokumenteve që kam hulumtuar, viti 1949 është i mbushur plot e përplot me nota dhe akuza të ndërsjella ndërmjet dy vendeve. Shpeshherë, MPJ-ja e Shqipërisë e akuzonte qeverinë jugosllave edhe për provokacione në kufirin midis dy vendeve.⁸³ Për të shmangur çdo incident apo provokacion të mundshëm, më 5 shtator 1949, qeveria jugosllave i dorëzoi Ministrisë së Punëve të Jashtme të Shqipërisë, përmes ambasadës së saj në Tiranë, një propozim për krijimin e komisioneve të përbashkëta për hetimin dhe shqyrtimin e incidenteve kufitare.⁸⁴

Udhëheqja komuniste e Shqipërisë ishte e vendosur të mbante larg në çdo formë dhe mënyrë marrëdhëniet me Jugosllavinë. Në një letër të shkruar me shkrim dore, dërguar Enver Hoxhës nga zëvendësministri i Punëve të Jashtme, Vasil Nathanaili, më 21 korrik 1949, i kërkohet nëse ishte dakord me komunikatën e përgatitur nga ky dikaster për ta transmetuar në ATSH lidhur me ndalimin e vizave për shtetasit jugosllavë.⁸⁵ Komunikata ishte e shkruar e gjitha në frymën e akuzës ndaj akteve armiqësore të ndërmarra nga Jugosllavia kundër Shqipërisë, dhe theksohej se kjo e fundit do të merrte masa energjike që këto veprime të mos kishin asnjë lloj efekti në vend.⁸⁶

⁷⁹ *Po aty*, V. 1949, D. 166, fl. 9. Njoftim i MPJ-së në Tiranë për legatën jugosllave, 26 prill 1949.

⁸⁰ *Po aty*, V. 1949, D. 168, fl. 1. Njoftim i legatës jugosllave në Tiranë dërguar MPJ-së, 26 janar 1949.

⁸¹ *Po aty*, V. 1949, D. 172, fl. 11. Lista e të arratisurve dhe kriminelëve të luftës që kishin kaluar në Jugosllavi.

⁸² *Po aty*, fl. 88.

⁸³ *Po aty*, V. 1949, D. 174, fl. 42. Provokacione ajrore të kryera nga jugosllavët gjatë muajit prill 1949.

⁸⁴ *Po aty*, fl. 107.

⁸⁵ *AQSH*, F. 14/Str., V. 1949, D. 469, fl. 7.

⁸⁶ *Po aty*, fl. 8.

Problemet e Shqipërisë me Jugosllavinë gjetën hapësirë të madhe në reagimet dhe njoftimet që kryente MPJ-ja në Tiranë, e cila nuk linte rast pas sulmuar Titon dhe "grupin" e tij në Tiranë (Xoxe, Kristo etj.) si edhe gjyqin që po zhvillohej kundër tyre.⁸⁷

Problemi i zgjidhjes së borxheve të Shqipërisë ndaj Jugosllavisë

Problemi më i madh në marrëdhëniet e Shqipërisë me Jugosllavinë, siç e kam theksuar në të tria pjesët e mëparshme të këtij studimi, ishin çështjet ekonomike. Për këtë arsye, u dërgua në Beograd një delegacion shqiptar, i cili qëndroi atje nga data 17 deri më 19 shtator 1949.⁸⁸ Në këto bisedime, pala shqiptare nuk i kishte pranuar kërkesat jugosllave mbi borxhin që Shqipëria i kishte Jugosllavisë si pasojë e kredive të akorduara nga kjo e fundit.⁸⁹ Në relacionin e datës 31 tetor 1949, nga delegacion shqiptar që kishte qenë në Beograd me autorizimin e qeverisë shqiptare për të diskutuar mbi çështjen e reparacioneve të Shqipërisë të mbetura në Jugosllavi, shprehej e gjithë marrëdhënia e acaruar mes dy vendeve.⁹⁰ Reparacionet në fjalë i takonin Shqipërisë pasi ishin dëmshpërblime lufte nga ana e Gjermanisë dhe për t'i marrë ato ishte bërë një marrëveshje mes dy vendeve për t'i kaluar ato [reparacionet] nga Jugosllavia.⁹¹ Të gjitha listat e reparacioneve që delegacioni shqiptar kishte paraqitur më datë 21 tetor 1949 ishin refuzuar nga Jugosllavia.⁹² Sipas relacionit të paraqitur nga delegacioni shqiptar, sasia e mallit që i përkiste Shqipërisë, por që refuzohej të dorëzohej nga autoritetet jugosllave ishte 4 000 tonë.⁹³ Po sipas të njëjtit burim, dëmi ekonomik i shkaktuar Shqipërisë nga ky bllokim vlerësohej në 29 031 893 lekë ku përfshiheshin interesat, deperimenti, fitimi i munguar si dhe tatimi mbi xhiron.⁹⁴ I gjithë relacioni iu dërgua më datë 31 tetor Enver Hoxhës me lutjen që ta studionte dhe të jepte vendimin përkatës.⁹⁵ Ndërkaq, edhe

⁸⁷ AMEPJ, V. 1949, D. 74, fl. 1. Njoftim i ambasadës shqiptare në Paris, 21 korrik 1949.

⁸⁸ *Po aty*, V. 1949, D. 163, fl. 103. Mbi vizitën e delegacionit ekonomik shqiptar në Beograd.

⁸⁹ *Po aty*, fl. 104.

⁹⁰ AQSH, F. 14/Str, V. 1949, D. 469, fl. 12.

⁹¹ *Po aty*.

⁹² *Po aty*.

⁹³ *Po aty*.

⁹⁴ *Po aty*, fl. 13.

⁹⁵ *Po aty*.

jugosllavët nuk kishin qëndruar në heshtje ndaj refuzimit shqiptar për të përbushur detyrimet e tyre financiare sipas marrëveshjeve të nënshkruara, dhe me anë të një note të datës 31 tetor 1949, dërguar MPJ-së në Tiranë nga ambasada jugosllave, Shqipërisë i kërkohej që të përbushte angazhimet e ndërmarra me vullnet të lirë.⁹⁶

Enver Hoxha kësaj bllokade jugosllave iu përgjigj në mënyrën e tij të papërgjegjshme për një kryeministër dhe ministër të Punëve të Jashtme. Ai ritheksoi faktin se Shqipëria kishte vepruar drejt kur denoncoi konventën ekonomike me Jugosllavinë dhe të gjitha protokollet që lidheshin me të.⁹⁷ Në "analizën" e tij, ai përsëriti thujtase *mot-á-mot* argumentet e shprehura më parë, si në denoncimin e konventës në korrik 1948, ashtu edhe në fjalimet e mbajtura në Plenumin XI (shtator 1948) dhe në Kongresin I (nëntor 1948). Personalisht, e kam të pamundur të besoj se Enver Hoxha nuk e dinte arsyen pse Jugosllavia kishte bllokuar mallrat e reparacioneve nga Gjermania që i takonin Shqipërisë. Kjo e fundit vazhdonte të ishte e varur nga kreditë që i kishte akorduar Jugosllavia në vitin 1946 dhe 1947. Pa shlyer këto kredi as që çoheshin ndër mend që Jugosllavia t'i bënte lëshime ekonomike Shqipërisë, pasi nuk kishte asnjë interes që ta lidhte me të.

Problematika ekonomike Shqipëri-Jugosllavi kishte vëmendjen e plotë të Byrosë Politike të KQ të PPSH-së. Për të pasur një ide sa më të qartë nëse Shqipëria do të mund të vijonte të ishte e varur nga Jugosllavia, udhëheqja komuniste shqiptare kërkoj një studim gjithëpërfshirës lidhur me këtë problem. Për hartimin dhe paraqitjen e këtij studimi u caktuan katër persona me ndikim (për aq sa mund të quhej i tillë) në udhëheqjen komuniste shqiptare. Studimi i paraqitur më datë 6 shtator 1949 nga Komisioni i Posaçëm, anëtarë të të cilit ishin Spiro Koleka, Manol Konomi, Kiço Ngjela dhe Abdyl Këllezi, përmban të dhëna tepër tronditëse mbi varësinë ekonomike të Shqipërisë ndaj Jugosllavisë për periudhën 1945-1948.⁹⁸ Duke qenë se Shqipëria ishte në

⁹⁶ *AMEPJ*, V. 1949, D. 191, fl. 3-5. Notë e qeverisë së Republikës Federative Popullore të Jugosllavisë drejtuar Ministrisë së Punëve të Jashtme të RPSH-së.

⁹⁷ *AQSH*, F. 14/Str., V. 1949, D. 469, fl. 15.

⁹⁸ *Po aty*, F. 14/Str., V. 1949, D. 690, fl. 1. Mbi shqyrtimin e dokumentacionit mbi çështjet ekonomike me Jugosllavinë, paraqitur nga Komisioni i Posaçëm. I njëjti informacion, lidhur me problematikat ekonomike ndërmjet Shqipërisë dhe Jugosllavisë dhe borxhet ndaj kësaj të fundit, gjendet edhe te Fondi i Bankës së Shtetit Shqiptar, viti 1949, dosja 72. Ky raport ishte përfunduar nga komisioni që në qershor 1949.

borxh "deri në grykë" me Jugosllavinë, që në faqen e parë të paraqitjes së studimit, komisioni rekomandonte që bisedimet të zgjateshin sa më shumë dhe shuma prej 3 138 296 450 dinarësh apo lekësh të konsiderohej si dëm që Jugosllavia i kishte shkaktuar Shqipërisë!⁹⁹

Dukej qartë se ishte një situatë e dëshpëruar për Shqipërinë. Studimi i paraqitur merr në shqyrtim të gjitha marrëveshjet me Jugosllavinë, duke filluar nga akordi i 25 shkurtit 1945 mbi çmimet tregtare dhe për pagesat midis dy vendeve, deri më 1 maj 1946.¹⁰⁰ Në bazë të evidencave të paraqitura për këtë hark kohor, Shqipëria detyrohej t'i paguante Jugosllavisë shumën prej 17 894 000 dinarësh.¹⁰¹ Po ashtu, akordi i nënshkruar më 1 korrik 1946, mbi bashkëpunimin ekonomik ndërmjet Shqipërisë dhe Jugosllavisë, parashikonte krijimin e gjashtë shoqërive shqiptaro-jugosllave, të cilat do të ishin totalisht nën dirigjimin jugosllav.¹⁰²

Akordi i nënshkruar më 1 korrik 1946, për një kredi prej 1 200 000 dollarësh, që qeveria e Republikës Federative Popullore e Jugosllavisë i jepte qeverisë së Republikës Popullore të Shqipërisë, do të përdorej për blerje mallrash në Jugosllavi.¹⁰³ Të gjitha çmimet e mallrave dhe pagesat për shërbimet do të caktoheshin në dollarë amerikanë, sipas mënyrës së parashikuar në akordin e përmendur mbi këmbimet tregtare dhe rregullimin e pagesave.¹⁰⁴ Për të qenë sa më të sigurt, jugosllavët kishin detyruar palën shqiptare që të nënshkruante një tjetër marrëveshje më datë 3 tetor 1946 për cedimin e kredive në dollarë nga Banka e Shtetit Shqiptar te Banka Kombëtare e Republikës Federative Popullore të Jugosllavisë.¹⁰⁵ Kjo marrëveshje u pasua nga një tjetër protokoll i

⁹⁹ *Po aty*. Pjesë nga raporti: "Duke qenë se neve nga bilanci i shkëmbimeve dalim me pagu shumën \$6 811 584,35 dollarë asht gjetë e arsyeshme që t'i shtohen këtij volumi në favor të gjitha damet e shkaktuara që vleftësohen (në lekë) 3 138 296 450 dinarë, kështu që dalim më mirë. Sostenimi i kësaj teze ka për qëllim të zgjasë sa më shumë bisedimet".

¹⁰⁰ *Po aty*, fl. 4.

¹⁰¹ *Po aty*.

¹⁰² *Po aty*, fl. 5. "Shoqëria për ndërtimin dhe shfrytëzimin e rrugës së hekurt; Shoqëria për ndërtimin dhe shfrytëzimin e minierave; Shoqëria për elektrifikimin; Shoqëria e Lundrimit Detar; Shoqëria tregtare për importim dhe eksportim si dhe Banka Shqiptaro-Jugosllave".

¹⁰³ *Po aty*, fl. 6.

¹⁰⁴ *Po aty*.

¹⁰⁵ *Po aty*.

nënshkruar më 27 nëntor 1946 për koordinimin (d'ajustement) e planeve ekonomike, bashkimin doganor dhe parifikimin (égalisation) e monedhave respektive të të të dyja vendeve.¹⁰⁶ Ky protokoll konsiderohej si pjesë plotësuese e Traktatit të Koordinimit të Planeve Ekonomike, të bashkimit doganor dhe të paritetit të monedhës, me anën e të cilit të dyja palët kontraktuese detyroheshin të merrnin të gjitha masat e nevojshme për të plotësuar detyrimet që rridhnin nga traktati i lartpërmendur.¹⁰⁷

Për ta pasur Shqipërinë edhe më shumë nën tutelën ekonomike, studimi përmendte kredinë e akorduar prej 2 miliardë dinarësh (40 milionë dollarë)* të nënshkruar në Beograd më datë 12 qershor 1947, e destinuar për ngritjen ekonomike të Shqipërisë.¹⁰⁸ Siç pranohet në këtë studim, qeveria shqiptare, nëpërmjet kësaj kredie të madhe, kishte arritur të shlyente kredinë e 1 korrikut 1946 duke paguar shumën e konvertuar në dinarë prej 36 718 032,76.¹⁰⁹ Kjo do të rezultonte një nga gabimet më të mëdha të Shqipërisë – një politikë ekonomike që nuk do t'i ndahej vendit deri në gjysmën e dytë të viteve '70, duke paguar borxhin me borxh.

Një tjetër marrëveshje, që ishte arritur sipas studimit për vitin 1948, ishte edhe ajo e shkëmbimit të mallrave ndërmjet dy vendeve për atë vit. Data e kësaj marrëveshjeje nuk paraqitet në këtë dokument, por Jugosllavia ishte zotuar t'i jepte në formë kredie Shqipërisë një të re në formë "ndihme" në shumën 3 miliardë dinarë, dhe Shqipëria do t'i jepte Jugosllavisë po në formë "ndihme" 1 miliardë dinarë.¹¹⁰ Sipas studimit, të gjitha këto marrëveshje ishin nënshkruar nga pala shqiptare në mirëbesim me bindjen se do t'i shërbenin Shqipërisë. Në mirëbesim?! Në fakt, Shqipëria ishte "falur" e tëra te Jugosllavia. Politika e verbër për të ruajtur me çdo kusht pushtetin kishte çuar në vijimin e një situatë

¹⁰⁶ *Po aty*, fl. 7.

¹⁰⁷ *Po aty*, fl. 8.

* Kursi i këmbimit i dinarit jugosllav me dollarin amerikan ishte: 1\$=50 dinarë për vitin 1946. Shih më gjerësisht Gjon Boriçi, "Mbijetesa e regjimit komunist në Shqipëri nga kreditë e vendeve të Lindjes 1945-1975", në *Historia dhe historiografia: Refleksione mbi Shqipërinë e viteve 1945-1990*, Akte të konferencës shkencore ndërkombëtare, (ed.) Afrim Krasniqi (Tiranë: Akademia e Studimeve Albanologjike, 2023), 286; shih edhe *AQSH*, F. 506/BSHSH, V. 1946, D. 55, fl. 1. Kurse këmbimi ndërkombëtare me bazë dollarin amerikan.

¹⁰⁸ *AQSH*, F. 14/Str, V. 1949, D. 690, fl. 19.

¹⁰⁹ *Po aty*, fl. 21.

¹¹⁰ *Po aty*, fl. 24.

katastrofike ekonomike për vendin. Ekonomikisht, Shqipëria, sipas marrëveshjeve që kishte nënshkruar, nuk ekzistonte më dhe ishte në rrugë e sipër për t'u bërë pjesë e shtetit jugosllav; pra, do të humbte pavarësinë – kësaj radhe, pa u shkrepur asnjë pushkë. Jugosllavia ishte shumë komode në këtë marrëdhënie "reciproke" ekonomike me Shqipërinë. Është e paimagjinueshme se ku e bazonte studimi shkeljen e traktateve nga pala jugosllave dhe dëmshpërblimin që guxonte të kërkonte Shqipëria. Sipas autorëve të studimit, synimi kryesor i Jugosllavisë ishte të impononte pikëpamjet e saj ekonomike ndaj Shqipërisë.¹¹¹ Jugosllavia akuzohej se kishte vonuar dërgesat e mallrave në Shqipëri dhe vetëm falë letrave të PKBS-së kundër Jugosllavisë ishtë bërë i mundur "zgjimi" politik dhe ekonomik i Shqipërisë.¹¹² Vetëm në saje të këtyre letrave ishte arritur të "kuptohej" se sa keq ishin zbatuar marrëveshjet nga ana e Jugosllavisë në raport me Shqipërinë.¹¹³

Nga hulumtimi i materialeve të ndryshme, të cilat i kam paraqitur edhe në pjesët e mëparshme të këtij studimi, del qartë se Jugosllavia nuk e kishte detyruar për asgjë Shqipërinë. Kishte qenë udhëheqja naive dhe tepër e paditur nën drejtimin e paskrupullt të Enver Hoxhës që kishte lejuar varësinë totale ekonomike të Shqipërisë ndaj Jugosllavisë. Studimi i paraqitur për vitet 1945-1948 nga të katër autorët pranoi se dakordësia për paritetin e monedhave ishte një gabim shumë i madh. Sipas autorëve, kjo dakordësi ishte në kundërshtim me raportin real 1 frangë shqiptare=12,50 dinarë jugosllavë, duke e çuar fillimisht në 1 frangë=9 dinarë derisa jugosllavët arritën ta ulnin në 1 frangë=3,50 dinarë.¹¹⁴ Kjo solli, sipas studimit, zhvlerësimin e fuqisë blerëse të Shqipërisë dhe pamundësinë e qarkullimit të mallrave.¹¹⁵ Studimi shkoi deri aty sa manovrat e jugosllavëve në të gjitha skemat ekonomike ndaj Shqipërisë i quante sabotime.¹¹⁶

Krijimi i Bankës së përbashkët Shqiptaro-Jugosllave, në vitin 1947, që në fillim të funksionimit të saj i kishte shkaktuar shtetit shqiptar një humbje prej 29 855 000 lekësh/dinarësh.¹¹⁷ Ky fakt e kishte detyruar

¹¹¹ *Po aty*, fl. 28-29.

¹¹² *Po aty*, fl. 29.

¹¹³ *Po aty*.

¹¹⁴ *Po aty*, fl. 30-31.

¹¹⁵ *Po aty*, fl. 31.

¹¹⁶ *Po aty*, fl 35. Shënimi me shkrim dore "sabotime".

¹¹⁷ *Po aty*, fl. 36.

palën shqiptare të derdhte në bankë edhe një shumë fillestare prej 3 milionë frangash, si dhe 10 500 000 lekë.¹¹⁸ Studimi vlerësonte se i gjithë synimi i palës jugosllave ishte që ekonomia e Shqipërisë të zhvillohej sipas metodës dhe nevojave të ekonomisë së Jugosllavisë dhe të mos kishte pavarësi.¹¹⁹ Duke pasur parasysh, sipas studimit, të gjitha këto çështje, më 30 qershor 1948, Kuvendi Popullor i RPSH-së denoncoi të gjitha marrëveshjet ekonomike të firmosura ndërmjet Shqipërisë dhe Republikës Federative Popullore të Jugosllavisë, përveç Traktatit të Miqësisë dhe Ndhmës Reciproke, i cili mbetej ende në fuqi.¹²⁰

Ç'vlerë kishte denoncimi i këtyre traktateve kur vetë në studim pranohet se ato ishin firmosur dhe ratifikuar rregullisht nga pikëpamja formale prej përfaqësuesve të të dyja vendeve?¹²¹ Vetë studimi e "fut në gropë" Shqipërinë, duke pranuar se këto marrëveshje nuk ishin të parregullta nga ana formale, por ishin denoncuar për shkak të mosrespektimit dhe të shkeljes së vazhdueshme nga ana e palës jugosllave, si edhe për shkak të mospajtimit dhe të moskorrespondimit të mbetjes së tyre në fuqi me shkakun dhe qëllimin fillestar të lidhjes së tyre.¹²²

Reagimin e palës jugosllave të datës 9 korrik 1948, studimi e konsideroi të pavend pasi pala jugosllave – siç e pranonte edhe pala shqiptare – i quante aktet ndërkombëtare si të përfunduara dhe të ratifikuara konform dispozitave të statuteve të të dyja vendeve.¹²³ Gjithashtu, në studim pranohet se këto marrëveshje ishin nënshkruar në përputhje të plotë me aktet e së drejtës ndërkombëtare dhe se duheshin zbatuar me skrupolozitet ndërmjet tyre (pacta sunt servanda).¹²⁴ Pala shqiptare po përpiquej të luante kartën e zbatimit të së drejtës

¹¹⁸ *Po aty*.

¹¹⁹ *Po aty*, fl. 53. "...që ekonomia shqiptare duhej të zhvillohej sipas eksigjencave të zhvillimit të ekonomisë Jugosllave, dhe jo independente".

¹²⁰ *Po aty*, fl. 55. "Ky vendim i Presidiumit të Kuvendit Popullor të Republikës Popullore të Shqipërisë për denoncimin e marrëveshjeve ekonomike iu njoftua Qeverisë së Republikës Federative Popullore të Jugosllavisë nga ana e Ministrisë së Punëve të Jashtme të Republikës Popullore të Shqipërisë me notën e saj dërguar më 1 korrik 1948 me ndërmjetësinë e Legatës së Republikës Federative Popullore të Jugosllavisë në Tiranë".

¹²¹ *Po aty*.

¹²² *Po aty*.

¹²³ *Po aty*, fl. 55-56.

¹²⁴ *Po aty*, fl. 56.

ndërkombëtare, sipas së cilës, kur njëra palë shkelte kontratat e nënshkuara, pala e dëmtuar (në këtë rast Shqipëria) kishte të drejtë ta konsideronte të shkelur këtë traktat dhe lirohej nga të gjitha detyrimet që rridhnin prej tij.¹²⁵

Denoncimi i traktateve me Jugosllavinë ishte bërë "deux ex machina" pa dërguar më parë një notë të vetme mbi pakënaqësitë e Shqipërisë ndaj palës jugosllave. Nuk është rastësi që të katër autorët e këtij studimi që në fillim të tij (shih më lart) e konsideronin këtë manovër thjesht për të fituar kohë në bisedime, në përpjekje për të gjetur burime të tjera financiare që të shlyheshin borxhet ndaj Jugosllavisë. Nota jugosllave e 3 korrikut 1948, ndër të tjera, shprehej hapur se, nëse ndonjë nga marrëveshjet nuk ishte realizuar, faji për këtë ishte i qeverisë shqiptare.¹²⁶ Sjellja e palës jugosllave, sipas autorëve, doli më qartë në pah përmes letrave të dërguara nga Bashkimi Sovjetik dhe Informbyroja, të cilat identifikonin largimin e udhëheqjes jugosllave nga parimet themelore të marksizëm-leninizmit.¹²⁷ Sipas studimit, ishte faji i palës jugosllave që kishte mohuar rrugën e ndërtimit të socializmit, ndaj ishte i kotë vazhdimi i mbajtjes së këtyre marrëveshjeve, pasi ato ishin abuzive dhe nuk i përgjigjeshin vullnetit të të dyja palëve kontraktuese që kishin pasur në kohën e nënshkrimit të tyre.¹²⁸ Pra, si pa të keq, palës shqiptare, sipas këtij arsyetimi tepër të pakuptimtë e banal, i lindte e drejta e denoncimit dhe, rrjedhimisht, e mosrespektimit të këtyre marrëveshjeve me Jugosllavinë "mbështetur në parimet themeltare të së drejtës ndërkombëtare".¹²⁹

Arsyetimi i të katër autorëve të këtij studimi, të thuash që ishte skandaloz, është vërtet pak. Shqipëria kishte marrë pará nga Jugosllavia

¹²⁵ *Po aty*.

¹²⁶ *Po aty*, fl. 58.

¹²⁷ *Po aty*, fl. 60.

¹²⁸ *Po aty*, fl. 61. "Në këtë mënyrë, duke ndryshuar, për fajin e palës Jugosllave, konditat dhe rrethanat e rëndësishme të përmendura që u kanë dhënë shkak lindjes dhe lidhjes së marrëveshjeve ekonomike, sidomos ato të ndërtimit të socializmit, të mos shfrytëzimit kapitalist dhe të pjesëmarrjes në familjen e madhe të popujve demokratikë dhe përparimtarë me në krye Bashkimin e Math Sovjetik, vazhdimi i mbajtjes së këtyre marrëveshjeve ekonomike është i kotë dhe abuziv, se nuk i përgjigjet vullnetit të dy palëve kontraktuese që kanë patur në kohën e lidhjes së tyre. Në këto kondita denoncimi i tyre ishte pasoja juridike e natyrshme e shkaktuar nga ndryshimi i rrethanave të patura parasysh në kohën e tyre".

¹²⁹ *Po aty*, fl. 61.

dhe kërkonte t'u bënte bisht marrëveshjeve. Mos ndoshta udhëheqësit shqiptarë të asaj kohe e konsideronin veten tepër të "zgjuar", pasi në vend nuk kishin rivalë, sa guxonin të mendonin se do t'ia hidhnin paq me Jugosllavinë? Mungesa e një tradite shtetformuese dhe, rrjedhimisht, administrative të gjatë, si edhe goditja që iu dha biznesit privat vendës që në fillimet e pushtetit, kishin sjellë këtë situatë. Pamundësia, si pasojë e politikave tepër të gabuara ekonomike që vendi të kishte pavarësi ekonomike, kur kishte arritur të kishte një bazë fillestare në vitin 1945, kishte çuar në këtë gjendje tepër të vështirë.

Studimi i paraqitur nga të katër autorët e lartpërmendur përpiket të tregojë të gjitha llojet e mundshme dhe të pamundshme të justifikimeve për t'u bërë bisht pagesave që Shqipëria i detyrohej Jugosllavisë. Të shmangie pagesat ishte krejtësisht e pamundur, edhe për faktin se një numër i madh i shumave të kredive që Jugosllavia i kishte akorduar Shqipërisë, BSHSH-ja i kishte depozituar në Bankën Kombëtare të Jugosllavisë, duke filluar nga 6 dhjetori 1946 e duke vijuar më 31 korrik 1947 dhe 16 gusht 1947.¹³⁰ Nga të gjitha këto manovra, sipas studimit, Shqipëria gjithnjë dilte me humbje ose me një përfitim tepër të vogël, çka lidhej edhe me rënien e fuqisë blerëse të monedhës së saj [lekut], një fenomen që kishte filluar që me ndryshimin e monedhës me dekretligjin nr. 445, datë 7 korrik 1947, kur franga u zëvendësua me lekun dhe, rrjedhimisht, me dinarin, si pasojë e parifikimit.¹³¹ Kjo manovër i kishte shërbyer sipas studimit tërësisht Jugosllavisë, pasi kishte ulur fuqinë blerëse të monedhës shqiptare.¹³² Sipas autorëve, nëse Shqipëria do të ruante standartin e monedhës së saj të re me frangën, atëherë 1 lek do të ishte i barabartë me 12,58 dinarë apo ndoshta edhe më shtrenjtë, 13,14

¹³⁰ *Po aty*, fl. 63. "Më 3 tetor 1946 midis dy Qeverive u nënshkrua në Beograd një protokoll, në bazë të të cilit Banka e Sh. Shqiptar do të vinte në dispozicion të Bankës Kombëtare të Jugosllavisë kredira në \$U.S.A. Më 6 dhjetor 1946 dhe suksesivisht më 7/1/1947 dhe 16/8/1947 Banka e Shtetit, efektivisht vuri në dispozicion të Bankës Kombëtare të Jugosllavisë shumën komplekse prej \$1.390.000".

¹³¹ *Po aty*, fl. 73. "Marrëveshja mbi koordinimin e planeve ekonomike, bashkimin doganor dhe parifikimin e monedhës, parashifte barazimin e lekut me atë të dinarit. Për të zbatuar këtë pjesë të Konventës Shteti Shqiptar, me dekret-ligjin N° 445 datë 7 korrik 1947, vendosi ndryshimin e sistemit monetar me bazë frangun me një sistem tjetër me bazë lekun. Raporti i shkëmbimit midis frangut dhe lekut u caktua me Fr. 1 baraz lekë 9 baraz dinarë 9. Ky raport nuk ishte i drejtë, pse nuk i korrespondonte vlefës reale të dy monedhave (Frangut dhe dinarit) në vendet respektive, n'atë kohë".

¹³² *Po aty*.

dinarë.¹³³ Jugosllavia përfitoi nga miopia e politikave ekonomike të Shqipërisë, bëri ndryshime arbitrare të çmimeve dhe raporti i shkëmbimit zbriti në 1 frangë=9 dinarë.¹³⁴

Personalisht, mendoj se të katër autorët e kishin të pamundur të shkruanin se qeveria shqiptare kishte gabuar rëndë. Madje, ata vetë pranuan se Shqipëria në vitin 1945 kishte stoqe të mëdha mallrash, përfshirë edhe ato që dërgoi UNRRA, por nuk guxuan të shkruanin se Reforma Agrare dhe shtetëzimet e industrisë kishin ndikuar në varfërimin e shoqërisë dhe të shtetit shqiptar.¹³⁵ Autorët bëjnë edhe një krahasim të fuqisë reale të frangës shqiptare me monedhat e huaja, ku shihet qartë se çfarë gafe apokaliptike kishte bërë qeveria e Enver Hoxhës me politikën e paritetit monetar me Jugosllavinë, vetëm e vetëm për të ruajtur pushtetin e tij.¹³⁶ Në këtë mënyrë, Jugosllavia arriti të përfitonte nga një marrëveshje, duke bërë që Shqipëria të paguante më shumë se 45 780 784 lekë si pjesë shtesë e kredisë prej 2 miliardë dinarësh.¹³⁷ Kjo manovër ishte shoqëruar edhe me një inflacion (rritje çmimesh) në Shqipëri.¹³⁸

Sipas studimit, për sa i përkiste kredisë prej 2 miliardë dinarësh, rezultonte se deri në gjashtëmuorin e parë të vitit 1948 për llogari të kësaj kredie kishin mbërritur në Shqipëri mallra me vlerë 1 432 735 204,84 dinarë.¹³⁹ Ndërsa për kredinë prej 3 miliardë dinarësh, akorduar

¹³³ *Po aty*, fl. 74.

¹³⁴ *Po aty*, fl. 75. "Ky veprim arbitrar u kundërshtua me këmbëngulje nga ana e jonë, por përfaqësuesi jugosllav Petroviç kërkoi të pranohej kjo pikëpamje e tij përndryshe ai e konsideronte vazhdimin e punës të pamundur, duke bërë insinuata se palës Shqiptare i mungonte sinqeriteti dhe bashkëpunimi i duhur".

¹³⁵ *Po aty*.

¹³⁶ *Po aty*, fl. 76. "Para parifikimit të monedhës, Banka e Shtetit Shqiptar praktikonte kurset që vijojnë, për valulat e divizat e huaja të poshtëshënuara dhe arrin: \$1=Fr. 2,80; Fr.Sc 100=71 Fr.; Fr.F. 100=1,55 Fr.; Kçs 100=6,20 Fr.; Lgs. 1=11,30Fr.; Fr.ar 1=1 Fr. Kur u ndryshua monedha dhe u arrit pariteti me dinarin jugosllav kursi i shkëmbimeve ishte si vijon: \$1=Lekë 50; Lgs 1=201,50 lekë; Fr.Sv. 100=1162,79 lekë; Fr.F. 100=23,38 lekë; Kçs. 100=100 lekë; Fr.ar. 1=16,30 lekë".

¹³⁷ *Po aty*, fl. 77. "Para parifikimit të monedhës, kanë arritur nga Jugosllavia për llog. të kredisë 2 miliard, mallra për dinarë 163.473.784, që janë vënë në shitje për Fr. 13.077.000, simbas kursit që ekzistonte n'atë kohë prej Fr. 1=dinarë 12,50. Pas parifikimit kjo shumë u konvertua në Lekë 117.693.000, kështu ndërsa Shteti realizoi lek 117.693.000, duhesh t'i paguante Jugosllavisë lekë 163.473.784 (për shlyerjen e kësaj pjese të kredisë prej 2 miliard) d.m.th. më tepër lekë 45.780.784".

¹³⁸ *Po aty*, fl. 81.

¹³⁹ *Po aty*, fl. 94.

në vitin 1948, kishin ardhur në Shqipëri mallra me vlerë 461 204 527,03 dinarë.¹⁴⁰ Kredia prej 3 miliardë dinarësh deri më 30 qershor 1948 ishte realizuar sipas autorëve në shumën 461 204 523,03 dinarë dhe e krahasuar me shumën që ishte planifikuar prej 1 800 000 000 dinarësh për këtë gjashtëmuor, përbënte vetëm 25,62% të saj.¹⁴¹

Siç shihet, rezultatet e marrëdhënieve "vëllazërore" të Shqipërisë me Jugosllavinë ishin katastrofike për të parën, dhe vetë autorët pranin se çmimet që do të duhej të paguante vendi ishin gjithnjë e më të larta se ato të tregjeve ndërkombëtare, mbi bazën e të cilave përcaktohej në mënyrë të drejtë vlera e mallrave të shkëmbyera ndërmjet dy shteteve sovraane.¹⁴² Për pagesat në dollarë amerikanë të kredive, Shqipëria kishte për t'i paguar sipas studimit shumën prej 7 143 318,40 dollarësh Jugosllavisë.¹⁴³ Sipas bilanceve të paraqitura edhe nga Banka e Shtetit Shqiptar, në favor të Jugosllavisë për kreditë e viteve 1946-1947 prej 1 dhe 2 miliardë dinarësh shuma që rezultonte ishte 1 464 940 195,15 dinarë/lek.¹⁴⁴ Për të tria kreditë, Shqipëria, sipas marrëveshjeve të nënshkuara, i detyrohej Jugosllavisë shumën prej 3 138 296 450 dinarësh (62 765 929 dollarë), sipas statistikave të BSHSH-së, të ndarë në 11 zëra, ku kjo shumë do të shpërndahej.¹⁴⁵ Sado kohë që të përpiquej të fitonte Shqipëria, siç rekomandonin autorët në fillim të këtij studimi, përfundimi ishte se pagesës nuk mund t'i shmangej.

Pas paraqitjes së këtij studimi, më 22 nëntor 1949, në një mbledhje të përbashkët të Byrosë Politike dhe Këshillit të Ministrave të RPSH-së, u mor në shqyrtim denoncimi i Paktit të Miqësisë ndërmjet Shqipërisë dhe Jugosllavisë, pasi ishte kjo e fundit që kishte dërguar një notë, e cila e

¹⁴⁰ *Po aty*.

¹⁴¹ *Po aty*, fl. 95.

¹⁴² *Po aty*, fl. 96. "Këto do të ishin rezultatet e marrëdhënieve tona ekonomike, në lidhje me kreditë, po të bazohemi tek çmimet e brendshme jugosllave, të cilat përmbajnë një akumulacion të madh, llogaritur aproksimativisht nga ne për dinarë 240.000.000. Por edhe sikur të zbritet akumulacioni nga vlefata e importimeve (me të cilin ra totali i importimeve tona do të arrinte për 2 dhe 3 miliardshin në dinarë 1.224.949.195,19), prapë çmimet rezultojnë gjithnjë më të larta nga ato të tregjeve ndërkombëtare, në bazë të të cilave caktohet në mënyrë të drejtë vlefata e mallrave të shkëmbyera ndërmjet dy shtetesh sovraane".

¹⁴³ *Po aty*.

¹⁴⁴ *Po aty*, fl. 185.

¹⁴⁵ *Po aty*, fl. 186.

denonconte e para ketë pakt.¹⁴⁶ Edhe pse në fund të mbledhjes u vendos që të denoncohej ky pakt, u pa e udhës që të shiheshin mirë llogaritë ndërmjet dy vendeve dhe se kush i detyrohej kujt.¹⁴⁷ Të bën përshtypje fakti se për këtë mbledhje nuk ekziston një procesverbal i rregullt, por vetëm një faqe shënimesh të çrregullta.

Përfundime

Në përfundim të këtij studimi të gjatë, i cili është botuar në katër numra të revistës "Studime historike", jo pak kolegë më kanë pyetur nëse Shqipëria i ka shlyer ndonjëherë borxhet ndaj Jugosllavisë. Fatkeqësisht, pyetjeve të tyre nuk mund t'u jap një përgjigje për momentin, pasi më duhet të kem akses në dokumentet e viteve '90 dhe 2000, të cilat ende janë të klasifikuara. Problemet ekonomike që Shqipëria kishte me Jugosllavinë gjatë marrëdhënieve të shkurtra "vëllazërore" janë rimarrë në studim nga Banka e Shtetit Shqiptar edhe në gjysmën e dytë të vitit 1984. Nga hulumtimi i një materiali me mbishkrimin "Tepër Sekret", del se, sipas studimit të kryer nga specialistët e BSHSH-së, edhe pse kishin kaluar 36 vjet nga denoncimi i këtyre traktateve dhe marrëveshjeve, Jugosllavia i kishte ende detyrime financiare të pashlyera Shqipërisë, në masën prej 53,1 milionë dollarësh.¹⁴⁸ Kjo shumë, sipas këtij studimi, justifikohet me faktin se kreditë 2 dhe 3 miliardë dinarësh të akorduara Shqipërisë ishin realizuar vetëm në masën 50,2% dhe në masën 25,6%.¹⁴⁹ Sipas hartuesve të studimit, Priamo Bollano dhe Perikli Samsuri, kjo situatë i kishte shkaktuar dëme të mëdha ekonomisë së vendit. Por ajo që duket më e dyshimtë në këtë studim është fakti se, nuk ishte lëvizur asnjë milimetër nga ajo çfarë kishin shkruar katër hartuesit e studimit të 1949-s, dy prej të cilëve u dënuan si armiq (Kiço Ngjela përfundoi në burg, ndërsa Abdyl Këllezi u pushkatua). Nëse katër hartuesit e studimit të 1949-s kishin pasur të paktën guximin të fitonin kohë, hartuesit e 1984-s shkojnë më larg duke thënë se dëmi i shkaktuar ekonomisë shqiptare nga

¹⁴⁶ AQSH, F. 490/Këshilli i Ministrave (më tej: KM), V. 1949, D. 98, fl. 1. Mbledhje e përbashkët e Byrosë Politike dhe e Këshillit të Ministrave të RPSH-së, mbi denoncimin e paktit të miqësisë ndërmjet Shqipërisë dhe Jugosllavisë.

¹⁴⁷ Po aty.

¹⁴⁸ AQSH, F. 506/BSHSH, V. 1949, D. 74, fl. 11. Studim tepër sekret i shtatorit 1984, i bazuar kryesisht në "Relacion mbi Marrëdhëniet Ekonomike midis Shqipërisë dhe Jugosllavisë (1945-1948)".

¹⁴⁹ Po aty, fl. 16.

pala jugosllave ishte sa vlera e kredive të akorduara nga Jugosllavia, pra 3 138 464 737 lekë ose dinarë?!¹⁵⁰ (meqë në atë vit kishte paritet ndërmjet dy monedhave, 1949). Sipas tyre, detyrimi i Shqipërisë ndaj Jugosllavisë ishte vetëm 7 143 318 dollarë, dhe kjo si rezultat i çmimeve më të larta krahasuar me tregun botëror që Jugosllavia i kishte paraqitur Shqipërisë në lidhje me kreditë prej 2 dhe 3 miliardë dinarësh.¹⁵¹ Të njëjtën logjikë (nëse mund të quhet e tillë) kishte përdorur qeveria shqiptare përmes Kryeministrit Mehmet Shehu, në një raport të paraqitur në vitin 1980, në lidhje me detyrimet që Republika Popullore e Kinës i kishte Shqipërisë për dëmet që i kishte shkaktuar si pasojë e ndërprerjes së kredive.¹⁵² Sipas kësaj logjike, kushdo që i kishte dhënë kredi Shqipërisë, e kishte dëmtuar atë, ndaj ishte në borxh ndaj saj!!!

Burime e bibliografi:

Arkiva:

Arkivi Qendror Shtetëror i Republikës së Shqipërisë (AQSH):

Fondet:

F. 14/Organet Udhëheqëse [OU]: 1948.

F. 14/Strukturat [Str.]: 1946, 1949.

F. 490/Këshilli i Ministrave [KM]: 1949.

F. 506/Banka e Shtetit Shqiptar [BSHSH]: 1946, 1948, 1949, 1980.

Arkivi i Ministrisë së Punëve të Brendshme/Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit [AMPB/AIDSSH]: 1948

Arkivi i Ministrisë për Europën dhe Punët e Jashtme i Republikës së Shqipërisë [AMEPJ]: 1948, 1949.

Literaturë:

CRAMPTON, Richard J. *The Balkans since the Second World War*. Essex: Longman, 2002.

¹⁵⁰ *Po aty*, fl. 10.

¹⁵¹ *Po aty*, fl. 7.

¹⁵² *AQSH*, F. 506/BSHSH, V. 1980, D. 70, fl. 1-6. Vendim i Qeverisë së Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë mbi dëmet e shkaktuara ekonomisë së vendit nga ndërprerja e njëanshme e kredive nga ana e Republikës Popullore të Kinës, 3 dhjetor 1980.

- GLENNY, Misha. *The Balkans 1804-1999; Nationalism, War and the Great Powers*. London: Granta books, 1999, 2000.
- HAUG, Hilde Katrine. *Creating a socialist Yugoslavia; Tito, communist leadership and the national question*. London & New York: I.B. Tauris, 2012.
- Historia dhe historiografia: Refleksione mbi Shqipërinë e viteve 1945-1990*. Akte të Konferencës Shkencore Ndërkombëtare, (ed.) Afrim Krasniqi. Tiranë: Akademia e Studimeve Albanologjike, 2023.
- HUPCHICK, Dennis P. *The Balkans; From Constantinople to Communism*. New York: Palgrave, 2001.
- JELAVICH, Barbara. *History of the Balkans; Twentieth Century*. Cambridge & New York: Cambridge University Press, 1983.
- MASTNY, Vojtech. *Il ditatore insicuro: Stalin e la Guerra Fredda*. Përktheu nga anglishtja Annalisa Agrati. Titulli i origjinalit, *The Cold War and the Soviet insecurity*. Milano: TEA, 1998.
- SYLA, Sabit & Lita, Qerim. *Marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave 1944-1948, Dokumente, vëll. I*. Prishtinë: Instituti i Historisë, 2020.

Shtypi:

Zëri i Popullit, Tiranë, 30 nëntor 1977.

ASSOC. PROF. DR. GJON BORIÇI

Institute of History / Academy of Sciences of Albania

Gjon.Borici@akad.gov.al

S u m m a r y

SETTLED ACCOUNT OR FAILED CALCULATION?
THE POLITICAL-ECONOMIC ANALYZES BETWEEN ALBANIA
AND YUGOSLAVIA AFTER STALIN-TITO RIFT
IN THE PERIOD JUNE 1948 - NOVEMBER 1949

This part of the study paper on Albanian-Yugoslav political and economic relations deals with the last phase of political and consequently economic quarrels between the two countries. Albania had so much to lose if the political and economic relations with Tito's Yugoslavia would continue. The Albania communist leadership was anxious to close all the

relations with Yugoslavia especially those of economic nature after the Soviet-Yugoslav rift. It was a great luck in the all meanings of the word the rift between Tito and Stalin in the early months of 1948 that saved Albania's independence. The wrong economic policies that Albania has pursued in her relations with Yugoslavia, after the careful research in the archives leave no doubt but the strongest conviction that the immature Albanian communist leadership would lead the country towards complete vassalage. However, the rift with Yugoslavia had a high price to be paid for Albania. The country was deeply indebted towards the northern-eastern neighbor and the main problem was to liquidate the huge amounts of debts (3 billion dinars) that Albania owed to Yugoslavia, nevertheless all this amount was not fully delivered from the Yugoslav government. All Albania had to do was to gain time in order to replace the former "benefactor" with a new one.

Key words: Albania, Yugoslavia, economy, financial obligations, politics.